



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

. ri i lëndës: 2018:057911
Datë: 28.03.2023
Numri i dokumentit: 04129818

PAKR.nr.103/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beqir Kalludra, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.G., nga Deçani, për shkak të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia, nga neni 181 të KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, dhe të akuzuarit I.C., nga Deçani, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Gjilan, së përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarve, av.Berat Tmava, së mbrojtësit së të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha dhe Erina Berisha, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.43/2019, të dt.14.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.23.03.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, dhe sipas detyrës zyrtare **anulohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.43/2019, të dt.14.12.2022, ashtu që çështja penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është anuluar sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe sipas detyrës zyrtare, ankesa e përfaqësuesit ligjor së të dëmtuarve, av.Berat Tmava, dhe ankesa e përbashkët e mbrojtësve së të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha dhe av.Erina Berisha, tani për tani janë jo lëndore.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.43/2019, të dt.14.12.2022, janë shpallur fajtor të akuzuarit, Sh.G., për shkak të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia nga neni 181 të KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose në posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK dhe I.C., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, ashtu që:

-të akuzuarit Sh.G., për veprën penale të përshkruara sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve, kurse për veprën penale të përshkruara sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve.

Në kuptim të nenit 80 par.1 lidhur me par.2 pika 2.2 të KPK, i është shqiptuar dënimi me burgim unik në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.23.09.2012, e gjerë në përfundim të dënimit të shqiptuar me burgim.

-të akuzuarit I.C., i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 2.000 (dymijë) Euro, të cilin dënim është obliguar që të paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në qoftese i akuzuari dënimin me gjobë nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj në afatin e caktuar, atëherë i njëjti do të zëvendësohet në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20Euro.

Të akuzuarit Sh.G., pas shpalljes së aktgjykimit i është vazhduar paraburgimi.

Janë obliguar të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 250 Euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 250 Euro, si dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 50 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Është konfiskuar arma e tipit “Bereta”, mod.92FS, kal.9mm, me numër serik BER706093, një karikator i të njëjtës armë dhe 11 fishek, si dhe pistoletë e tipit “Blow 92”, e kal.9mm, me numër serik 15-13061191, një karikator dhe një fishek. Të njëjtat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen pasi që gjenden në ruajtje sipas rastit policor 2018-DC-338.

Të dëmtuarit I.T., N.T., A.C., për realizmin e kërkesë pasurore juridike, janë udhëzuar në kontestin e rregullit juridiko civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.43/2019, i dt.14.12.2022, të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje apo i njëjti të ndryshohet dhe të akuzuarit Sh.G., për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën I të dispozitivit, vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par.1.5 të KPK, të shqiptohet dënim konform dispozitave përkatëse ligjore, si dhe për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën II të dispozitivit të aktakuzës, mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, ti shqiptohet dënim me burgim më i ashpër, e po ashtu edhe të akuzuarit I.C., për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën III të dispozitivit ti shqiptohet dënim më i ashpër.

Përfaqësuesi i autorizuar i palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje, apo që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe i akuzuari Sh.G., për veprën penale të përshkruar sikurse në pikën I të dispozitivit të aktakuzës – vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par.1.5 dhe veprës penale mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, ashtu që ti shqiptohen dënime më të ashpra.

Sa i përket të akuzuarit I.C., edhe të njëjtit ti shqiptohet dënim më i ashpër, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat rënduese.

Ankesë kanë ushtruar mbrojtësit, e të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, dhe av.Erina Berisha për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet dhe të akuzuarit Sh.G., ti shqiptohet dënim më i butë, lidhur me veprat penale për të cilat është shpallur fajtor.

Po ashtu përgjigje në ankesë të përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit, kanë ushtruar mbrojtësit e të akuzuarit Sh.G., dhe kanë propozuar që ankesa e përfaqësuesit të autorizuar së të dëmtuarit, të refuzohet si e pabazuar, ose e njëjta të hudhet si e pa lejuar.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.102/2023, të datës 21.02.2023, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, dhe përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava, përkitazi me vendimin lidhur me sanksionin penal, kanë propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje, apo që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe i akuzuari Sh.G., të shpallet fajtor për shkak të veprës penale për të cilën edhe akuzohet, vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën par.1.5 të KPK dhe ti shqiptohet dënim sipas ligjit, ndërsa për veprën penale mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, ti shqiptohet dënim me burgim efektiv me kohëzgjatje më të gjatë sesa me aktgjykimin e ankimuar. Sa i përket ankesës së përbashkët nga ana e mbrojtësve së të akuzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha dhe av.Erina Berisha, e po ashtu edhe përgjigjes në ankesë të njëjtat të refuzohen si të pabazuara.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.23.03.2023, dhe i ka njoftuar në mënyrë të rregullt të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në seancë të kolegjit kanë prezantuar i akuzuari Sh.G., i cili është sjellë nga njësitë e transportit të parburgosurve, I.C., i dëmtuari I.T., e dëmtuara N.T., përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av.Berat Tmava, dhe mbrojtësi i të akzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha.

Nuk kanë prezantuar prokurori i Prokurorisë së Apelit, e dëmtuara A.C., mbrojtësja e të akzuarit Sh.G., av.Rina Berisha, përkundër asaj që janë njoftuar në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av.Berat Tmava, para se të fillohet me seancë të kolegjit ka propozuar që mos të fillohet me një njëjtën dhe të sigurohet prezenca e Prokurorit të Apelit.

Kolegji në kuptim të nenit 390 të KPPK, ka njoftuar të gjithë të pranishmit se ekzistojnë kushtet ligjore për mbajtjen e seancës së kolegjit dhe se prokurori është njoftuar në mënyrë të rregullt, por nuk i është përgjigjur njoftimit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, ka deklaruar se ngel në tërësi pranë ankesës së ushtruar, duke theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me dy aktakuza, njëra e ngritur nga ana e Prokurorisë Themelore në Pejë, e cila ka rezultuar nga shkresat e lëndës, dhe aktakuza tjetër e ngritur nga ana e PTH në Gjilan, e cila është e kundërligjshme dhe fiktive, kurse gjykata besimin ia ka falur të njëjtës aktakuzë.

Sa i përket dënimeve të shqiptuara propozojnë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të të akzuarve tu shqiptohen dënime më të ashpra, apo që çështja penale të kthehet në rigjykim e vendosje në gjykatë të shkallës së parë.

Me këtë paraqitje të përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar, janë pajtuar të dëmtuarit, I.T. e N.T..

Mbrojtësi i të akzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha, ka theksuar se ngel në tërësi pranë ankesës së ushtruar, duke theksuar se e njëjta është paraqitur vetëm për shkak të vendimit lidhur me lartësinë e sanksionit penal, duke theksuar se i akuzuari Sh.G., e ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale, dhe se është vepruar në kuadër të dispozitave përkatëse ligjore.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava, mbrojtësve së të akzuarit Sh.G., av.Besnik Berisha dhe av.Erina Berisha, si dhe përgjigjes në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, si dhe përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, të ushtruara nga ana e av.Besnik Berisha dhe av.Erina Berisha, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti

i Krimeve të Rënda, PKR.43/2019, të dt.14.12.2022, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të tjera të cilat kushtëzojnë anulimin e tij.

Prokuroria Themelore në Gjilan, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 383 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 384 par.1 nën par.1.12 të KPPK, duke theksuar se nga ana e gjykatës së shkallës së parë gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sepse janë shkelur dispozitat përkatëse ligjore, duke u bërë ndryshimi i kualifikimit juridik të veprës penale dhe atë nga vepra penale e vrasjes së rëndë në veprën penale vrasje nga pakujdesia, që nënkupton se kjo ka ndodhur pasi që është rihapur shqyrtimi gjyqësor. Po ashtu shkeljet esenciale manifestohen në dispozitën ligjore nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPPK, lidhur me nenin 370 par.6,7,8 të KPPK, sepse gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsye për të gjitha pikat e aktgjyimit, sikurse kërkohet në dispozitën përkatëse ligjore, e po ashtu nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë, se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara apo të pa vërtetuara, që nënkupton se ka kundërthënie në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu në mënyrë të qartë dhe të plotë nuk është vërtetuar saktësia e secilës provë e cila është e paraparë në aktgjykim, andaj në këtë drejtim vie deri te përfundim se gjykata e shkallës së parë nuk e ka zbatuar në mënyrë të duhur dispozitat përkatëse ligjore, përkundër asaj që ka pasur obligim ligjor që të njëjtat ti zbatoj.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e prokurorisë, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti përfshihet me shkeljet të cilat nuk mund të jenë pjesë përbërëse e çështjes penale dhe të njëjtat aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e bëjnë të pa kuptueshëm. Është e vërtetë se në këtë çështje penale, është mbajtur shqyrtimi gjyqësor, dhe është nxjerrë aktgjykimi PKR.nr.43/2019, i dt.14.12.2022, mirëpo gjykata e shkallës së parë, nuk i ka vlerësuar në masë të duhur të gjitha provat të cilat e karakterizojnë çështjen penale, dhe të akuzuarin e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia, nga neni 181 të KPK, dhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, e po ashtu edhe të akuzuarin I.C., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë çështje penale është filluar me shqyrtimin gjyqësor sipas aktakuzës PP/I.nr.89/2018, të dt.12.06.2019, dhe i akuzuari Sh.G., është akuzuar për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 nën par.1.5 të KPK, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, dhe kundër të akuzuarit I.C., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK. Në këtë çështje penale pasi që është caktuar shqyrtimi fillestar, është bërë leximi i aktakuzës, dhe i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë, e pasi që të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë, atëherë është vazhduar në procedurë sikurse kërkohet dispozitat përkatëse ligjore.

Në rrjedhje të kësaj çështje penale, nga aktgjykimi vlerësohet se derisa është bërë rikualifikimi juridik i veprës penale, të vrasjes së rëndë, në veprën penale të vrasjes nga pakujdesia, kemi pasur dy aktakuza, dhe për të sqaruar ekzistimin e veprës penale për të cilën është menduar se duhet të jetë objekt shqyrtimi në këtë çështje penale, gjykata e ka filluar me dëgjimin e deklaratave të dëshmitarëve-të dëmtuarit I.T., N.T., A.H., F.Z., A.C., po ashtu dhe të dëshmitarëve D.T., S.T., N.M., F.M., N.Gj., Z.T., L.P., Sh.T., G.B., Z.B., e po ashtu janë dëgjuar edhe ekspertët e ekspertizave nga shkresat e lëndës, sikurse është eksperti Qëndrim Topalli, ekspert i balistikës, eksperti i balistikës Lutfi Rraci, eksperti mjeko ligjor, Dr.Arsim Gërxhaliu, po ashtu në cilësinë e dëshmitarëve janë dëgjuar edhe zyrtari policor T.M., R.M., B.T.-krim teknik, zyrtari policor P.M., zyrtari policor Y.H., krim tekniku S.L., eksperti Lutfi Rraci, ka bërë përshkrimin e ekzistimit të veprës penale, duke u mbështetur në provat materiale nga shkresat e lëndës, mirëpo kolegji ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar ekzistimin e veprës penale, për të cilën e ka shpallur fajtor të akuzuarin, si dhe rezulton se në masë të duhur nuk janë vlerësuar të gjitha provat të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj lënde penale për të gjetur përfundimin e rikualifikimit të veprës penale nga vepra penale e vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 pika 1.5 të KPK, në veprën penale të vrasjes nga pakujdesia, nga neni 181 të KPK.

Përkundër asaj që është bërë rihapja e shqyrtimit gjyqësor, megjithatë nuk ka mundur gjykata e shkallës së parë, që të vërtetoj motivin e kryerjes së veprës penale, i cili është me rëndësi sepse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, nuk ka paraqitur kurrfarë motivi të kryerjes së veprës penale, andaj si i tillë dispozitivi ka mbetur i mangët. Po ashtu në cilësi të dëshmitarëve janë dëgjuar edhe zyrtarët policor H.D., pastaj dëshmitarit A.H., por nga të njëjtat deklarata prapë nuk është mundur që të kuptohet se për çfarë lloj të veprës penale bëhet fjalë, është fjala për veprën penale të vrasjes së rëndë, apo të veprës penale vrasje nga pakujdesia, duke pasur parasysh se secila vepër penale e paraparë me dispozitën përkatëse ligjore, sikurse është vepra penale e vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 nën par.1.5 të KPK, ku theksohet se privon nga jeta personin tjetër, dhe me atë rast me dashje venë në rrezik jetën e një ose më shumë personave të tjerë, rezulton se kjo çështje nuk është sqaruar dhe se jeta e cilit person është vënë në rrezik, por është kaluar menjëherë në rikualifikimin juridik, dhe i akuzuari është akuzuar për shkak të veprës penale të vrasjes nga pakujdesia, të përshkruar në dispozitën ligjore, nga neni 181 të KPPK, në të cilën thuhet “kushdo që e privon nga jeta personin tjetër nga pakujdesia, dënohet me burgim, prej 6 muaj deri në 5 vite”.

Po qesë bëhet një krahasim në mes të veprës penale ekzistuese dhe asaj e cila ka qenë e paraparë, kur është ngritur aktakuza e parë, në të cilën thuhet se e ka privuar nga jeta tani të ndjerin, i cili ka qenë duke komunikuar me telefon, atëherë parashtrohet pyetja, se cilët persona kanë qenë afër dhe ka mundur tu rrezikohet jeta, ngase nga shkresat e lëndës theksohet se A.H., A.T. dhe F.Z., kanë qenë në një largësi në distancë prej 70cm në mes veti, ndërsa në raport me të akuzuarit ka qenë distanca 4-5m, dhe nga kjo shkrepje goditet tani i ndjeri A.T., dhe nga plagët e marra i njëjti edhe ka ndërruar jetë. Po ashtu gjykata e shkallës së parë, është dashur që në aktgjykim të jep konstatimin pasi që ka dëgjuar ekspert nga kjo çështje penale, sikurse janë, eksperti i balistikës, eksperti mjeko ligjor, ekspertët e krim teknikes, nga të cilat ekspertiza me

siguri që do të vërtetohej secila veprë penale në rastin konkret është kryer nga ana e këtu të akuzuarit.

Gjykata e shkallës së parë, është dashur që të bëjë vlerësimin e secilës deklaratë, të secilit të dëmtuar apo dëshmitar, apo ekspertin e fushës përkatëse, të vlerësoj se i akuzuari a ka pasur njohuri për përdorimin e armëve, se arma e përdorur a është përdorur ndonjëherë tjetër nga ana e këtu të akuzuarit, kurse përkundër asaj që i akuzuari e ka bërë pranimin e fajësisë për këtë veprë penale, rrjedha e procedurës ka shkuar në drejtim të asaj që në këtë çështje penale është dashur të vlerësohen të gjitha dispozitat përkatëse ligjore, se a janë përmbushur elementet për pranimin e fajësisë, sidomos duke pasur parasysh natyrën e veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, e më pastaj të vendoset për të njëjtën.

Po ashtu aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar dhe për shkak të shkeljeve të ligjit penal, duke theksuar se në këtë çështje penale, fillimisht është filluar shqyrtimi gjyqësor për shkak të veprës penale të vrasjes së rënd nga neni 179 par.1 nën par.1.5 të KPK, duke pasur parasysh të gjitha karakteristikat e kësaj veprë penale si dhe dispozitën përkatëse ligjore, mirëpo më pastaj është bërë rikualifikimi i së njëjtës, që parashtrohet pyetja se vepra për të cilën është shpallur sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, PKR.nr.43/2019, të dt.14.12.2022, vrasje nga pakujdesia, a i përmbushë elementet e ekzistimit të së njëjtës, duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, elementet e figurës së kryerjes së të njëjtës, që ndërliken me veprimet e të akuzuarit Sh.G..

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së prokurorisë dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përfshihet me shkeljet e ligjit penal, të parapara në nenin 385 të KPPK, sepse gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar në masë të duhur të gjitha elementet e ekzistimit të veprës penale, për të cilën e ka shpallur fajtor të akuzuarin, kurse nga rrethanat e kryerjes vije në përfundim se në këtë çështje penale është zbatuar ligji i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, si dhe gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore.

Edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, prokuroria e ka ankimuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke ardhur në përfundim se të gjitha provat të cilat janë pjesë përbërës e kësaj çështje penale nuk janë vlerësuar në mënyrë të duhur, përkundër asaj që të njëjtat kanë qenë të mjaftueshme për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, kurse rikualifikimi juridik i bërë nuk është në përputhshmëri me ekzistimin e veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit.

Gjykata e shkallës së parë, ka ngritur aktakuzë kundër të akuzuarit Sh.G., dhe I.C., dhe në këtë çështje penale ka vlerësuar në masë të duhur të gjitha provat të cilat i ka proceduar, mirëpo nuk ka vërtetuar se për cilën veprë penale është dashur që të shpallet fajtor i akuzuari Sh.G., dhe se të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë hetimeve, kanë pasur mbështetjen e duhur ligjore. Sa i përket kësaj çështje penale nga të gjitha provat personale si dhe ato materiale, nuk mund të vërtetohet ekzistimi i veprës penale të vrasjes nga pakujdesia, sikurse është shpallur fajtor këtu i akuzuari.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së prokurorisë, për shkak të vërtetimit të gjendjes faktike, dhe ka ardhur në përfundim se pasi që aktgjykimi përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, atëherë edhe gjendja faktike në këtë çështje penale nuk është vërtetuar në masë të duhur, sepse nuk janë vërtetuar të gjitha elementet përkitazi me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale e cila është objekt shqyrtimi, e po ashtu gjykata e shkallës së parë është dashur që të ketë parasysh motivin e kryerjes së veprës penale, i cili nga dispozitivi i aktgjykimit nuk figuron, për të vërtetuar se cilat ka qenë arsyeja për të kryer këtë vepër penale, të cilat kanë qenë njohurit këtu të akuzuarit Sh.G., për përdorimin e armës, se arma e përdorur a ka qenë e përdorur ndonjë rast tjetër, a ka qenë në gjendje të rregullt, përkundër asaj që janë bërë disa lloje të ekspertizave që janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

Sa i përket ankesës për shkak të vendimit të sanksionit penal, të ushtruar nga ana e prokurorisë, po ashtu dhe nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të palëve të dëmtuara, av.Berat Tmava, si dhe ankesës së përbashkët të av.Besnik Berisha e av.Erina Berisha, kolegji i kësaj gjykate të njëjtat nuk ka shqyrtuar për këtë bazë ankimore, sepse ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj në këtë drejtim nuk mund të vihet deri te përfundimi se në këtë çështje penale, vendimi për dënimin a ka qenë i drejtë apo jo i drejtë, pasi që shkeljet të cilat mendohet se janë kryer nga ana e gjykatës së shkallës së parë, janë të pa kalueshme për të vendosur për këtë bazë ankimore.

Sa i përket çështjes së paraburgimit, është shqyrtuar i njëjti, por kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se i njëjti duhet të zgjatet, ngase ende ekzistojnë kushtet ligjore, që i akuzuari Sh.G., të qëndroj në paraburgim.

Nga arsyet e cekura më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 402 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.103/2023, të datës 23.03.2023

Bashkëpunëtori profesional,
Endrit Ajeti

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetar i kolegjit,
Beqir Kalludra

Kadrije Goga Lubishtani